REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER NATASHA Z. XHAÇKA
ADRESA NR.5, SAMI FRASHERI,
NR.3, NR.1, NR.12
TEL: 682094140

MARRËVESHJE SIGURUESE

(MARRËVESHJE E BARRËS SIGURUESE KUOTA/AKSIONE)

Nr. repertori: 1189 **Nr. koleksioni: 575**

Tirane më 28/07/2021

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

A2021051330060139775

*Akti noterial përbëhet nga 4 fletë

REPUBLIKA SLOVENIJA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
Nr._____ Rep. Nr._____ Kol.

MARRËVESHJE SIGURUESE

Sot, më datë 28.07.2021, të vitit 2021 (dy mijë e njëzetë e një), në TIRANË, para meje N. XHAÇKA, anëtar i Dhomës Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË u paraqitën:

BARRËMARRËSE / KREDIDHËNËSE:

UNION BANK SH.A. person juridik i regjistruar me vendimin Nr.33563, datë 26 Maj 2005, te Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NIPT K51807801R, me seli në adresën Bulevardi Zogu i Parë, pallati 13 katësh, përballë stacionit të trenit, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga: **Zj. Enkeleda Hasho,** shtetase shqiptare, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, e bija e Idris-it, lindur me 21 Tetor 1974, mbajtese e leternjoftimit me nr. 036677101 dhe nr. personal H46021032E dhe **Z. Gent Drita,** shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i biri i Spiro-s, lindur në datë 08 Tetor 1978, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit Nr. 035003868 dhe me Nr. Personal H81008138K

dhe

BARRËDHËNËS

"ADRIATIC BAY INVESTMENT GROUP" Sh.P.K. person juridik regjistruar prane QKB më datë 20 nëntor 2018 dhe në organet tatimore me NIPT L82320043A, me seli në adresën: Sheshi Italia, Mak Albania Hotel, kati I pare, 1000 Tirane, e përfaqësuar sipas vendimit te asamblese date 27.07.2021 nga administratori i shoqërisë **Ahmet Kastrati,** shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i biri i Maksutit, lindur në datë 20 prill 1991, në Krumë, Kukes, banues në Rezidenca Garden Turdiu, Njesia nr.7, Laprake, Tirane, mbajtës i letërnjoftimit me nr.037250008.

Baza Ligjore

Kjo kontrate hartohet bazuar ne nenet 6, 24, 31, 420, 546, 605, 1031 e ne vazhdim te Kodit Civil,
- Ligjit nr.110/2018, dt.20.12.2018 "Per Noterine"
- Ligjit nr.8537, date 18.10.1999 "Per barret sigururese".

Palet kane rene paraprakisht dakort qe te lidhin kete Marreveshje Siguruese me kushtet e meposhtme.

1. Krijimi i Barres dhe Detyrimit te Siguruar

Barredhenesi me kete marreveshje vendos ne favor te Bankes/Barremarrese nje barre siguruese (se ciles me poshte i referohemi me emertimin "Barre Siguruese") mbi :

- **99 % (nëntëdhjetë e nëntë përqind) të kuotave të shoqërisë koncesionare "Porti MBM" (Multi Buoy Mooring) (Shoqeri e thjeshte)** person juridik regjistruar prane QKB më datë 21 prill 2015 dhe në organet tatimore me NIPT L51621501S, me seli në adresën Porto Romano, Durrës, e përfaqësuar sipas vendimit te asamblese date 27.07.2021 nga administratori i shoqërisë **Z. Ahmet Kastrati,** shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i biri i Maksutit, lindur në datë 20 prill 1991, në Krumë, Kukes, banues në Rezidenca Garden Turdiu, Njesia nr.7, Laprake, Tirane, mbajtës i letërnjoftimit me nr.037250008 që po zbaton Kontratën Koncesionit të formes BOT (ndertim, shfrytezim dhe transferim) per ndertimin, shfrytezimin dhe transferimin e nje porti te llojit MBM , ne Porto-Romano, Durres, lidhur me dt 21.07.2015, dhe amenduar sipas ligjit 13/2018 dhe ligjit 58/2020, ndermjet Ministrise se Transportit dhe Infrastruktures te Republikes se Shqipersie dhe Shoqerise koncesionare Porti MBM (Multi Buoy Mooring) ketu e me poshte referuar si "Kolateral Specific.

1.2 Barra Siguruese e dhene ne piken "1.1" shërben si mjet sigurimi për të garantuar *Bankën* për shlyerjen e cdo Kredie ekzistuese dhe te ardhshme ne formen e Huase, Overdraftit, Leter Garancise Bankare, Leter Kredise etj, dhe të gjitha detyrimeve të lidhura me to qe Banka i ka dhene dhe do ti jape Kredimarresit:

a) **Shoqeria koncesionare "Porti MBM" (Multi Buoy Mooring) (Shoqeri e thjeshte)** person juridik regjistruar prane QKB më datë 21.04.2015 dhe në organet tatimore me NIPT L51621501S, me seli në adresën: Porto Romano, Durrës, e përfaqësuar sipas vendimit te asamblese date 27.07.2021 nga administratori i shoqërisë: **Z. Ahmet Kastrati,** shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i biri i Maksutit, lindur në datë 20 Prill 1991, në

Krumë, Kukes, banues në Rezidenca Garden Turdiu, Njesia nr.7, Laprake, Tirane, mbajtës i letërnjoftimit me nr.037250008 dhe me nr. Personal J10420024H, dhe

b) **"ADRIATIC BAY INVESTMENT GROUP" sh.p.k.** person juridik regjistruar prane QKB më datë 20.11.2018 dhe në organet tatimore me NIPT L82320043A, me seli në adresën: Sheshi Italia, Mak Albania Hotel, kati i pare, 1000 Tirane, e përfaqësuar sipas vendimit te asamblese date 27.07.2021 nga administratori i shoqërisë: **Ahmet Kastrati,** shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i biri i Maksutit, lindur në datë 20 Prill 1991, në Krumë, Kukes, banues në Rezidenca Garden Turdiu, Njesia nr.7, Laprake, Tirane, mbajtës i letërnjoftimit me nr.037250008 dhe me nr. Personal J10420024H sipas kontratave te kredive qe jane lidhur dhe do te lidhen ne te ardhmen deri ne **Limitin kreditor te aprovuar** prej **EUR 7,500,000.00** (vetëm **shtatë milion e pesëqind mijë euro**)

1.3 Kjo Marreveshje Siguruese eshte pjese perberese dhe e pandare e Kontratave te kredise qe jane lidhur dhe qe do te lidhen ne te ardhmen ndermjet Bankes dhe Kredimarresit **Shoqeria koncesionare "Porti MBM" (Multi Buoy Mooring) (Shoqeri e thjeshte)** dhe **"ADRIATIC BAY INVESTMENT GROUP" sh.p.k.** te treguara ne piken 1.2 me lart, deri ne ripagimin e plote dhe pa kushte te shumes se cdo kredie te kredimarresit te mesiperm dhe te te gjitha detyrimeve sipas afateve dhe kushteve te percaktuara ne Kontratat e Kredive perkatese.

2.Premtimet e Barredhenesit

Barredhenesi bie dakort dhe premton se:

2.1 Do të lejojë transferimin e kolateralit specifik në emër të Bankës në rast mospërmbushjeje me qëllim garantimin e Kontratat e Kredise, Overdraftit, Leter Garancise, Leter Kredise etj, dhe të gjitha detyrimeve të lidhura me to qe Banka i ka dhene dhe do ti jape kredimarrësit **Shoqeria koncesionare "Porti MBM" (Multi Buoy Mooring) (Shoqeri e thjeshte)** dhe **"ADRIATIC BAY INVESTMENT GROUP" sh.p.k..**

2.2 Ne qofte se i behet kerkese, te jape me shkrim çdo informacion ne lidhje me Kolateralin Specifik dhe te lejoje Barremarresin qe here pas here te verifikoje kete kolateral duke kerkuar informacion mbi llojet e kontratave aktuale dhe ne te ardhmen.

2.3 Ne qofte se i behet kerkese, te ekzekutoje, njohe dhe jape detyra, transferta dhe dokumenta ashtu siç mund t'i kerkohet ne menyre te arsyeshme nga Barrenarresi ne menyre qe t'i jepet efekt kesaj Marreveshjeje si dhe te paguaje te gjitha kostot e kerkimit dhe rregjistrimit ne rregjister;

2.4 T'i paguaje Barremarresit shpenzimet apo kostot, duke perfshire shpenzimet ligjore te bera nga Barremarresi per te vene ne ekzekutim kete Marreveshje ose per te ekzekutuar te drejtat e tij mbi Kolateralin Specifik, si dhe shpenzimet per rregjistrimin e njoftimeve dhe kerkimin e informacionit ne Rregjister ne lidhje me barren siguruese te krijuar nga kjo marreveshje;

2.5 Te njoftoje menjehere Barremarresin n.q.se Kolaterali Specifik tjetersohet;

2.6 Te njoftoje menjehere Barremarresin per ndryshim te emrit te Barredhenesit;

2.7 Te moste tjetersoje,barresoje Kolateralin Specifik ose çdo aksesor apo pajisje te lidhur me te pa miratimin me shkrim te Barremarresit;

3. Mbarimi i Barres Siguruese

3.1 Barra Siguruese do t'i lirohet Barredhenesit vetem pas permbushjes ne menyre te plote dhe te parevokueshme te te gjithave detyrimeve qe rrjedhin nga Kontratat e Kredise, Overdraftit, Leter Garancise, Leter Kredise etj, dhe të gjitha detyrimeve të lidhura me to qe Banka i ka dhene dhe do ti jape kredimarrësit **Shoqeria koncesionare "Porti MBM" (Multi Buoy Mooring) (Shoqeri e thjeshte)** dhe **"ADRIATIC BAY INVESTMENT GROUP" sh.p.k.** duke kryer njekohesisht edhe ç'regjstrimin nga Regjistri i Barreve Siguruese.

4. Rasti i Mospermbushjes

Nese rrethanat e pershkruara me poshte do te vertetohen, atehere kjo do te konsiderohet mospermbushje (me poshte referuar si "mospermbushje"):

4.1 Nese Barredhenesi nuk do te paguaje Barremarresin, kur pagimi behet I detyrueshem, çdo shume qe I detyrohet Barremarresit sipas kesaj marreveshjeje apo ndonje tjetre te lidhur me kete, ose ne qofte se Barredhenesi nuk do te permbushe ndonje premtim ose kusht tjeter te kesaj marreveshjeje apo ndonje tjetre te lidhur mes Barredhenesit dhe Barremarresit;

4.2 Nese ndonje deklarim bere nga Barredhenesi ne lidhje me kete marreveshje merret vesh te jete I pasakte;

4.3 Nese do te duhet te ekzekutohet nje vendim gjyqesor ndaj Barredhenesit;

4.4 Nese çdo pale tjeter qe pretendon te kete barre siguruese mbi Kolateralin Specifik, ndermerr hapa per te ekzekutuar barren e vet siguruese;

4.5 Nese sipas mendimit te Barremarresit, dhe mbi baza tregtare te arsyeshme, Barra Siguruese ose Kolaterali Specifik rrezikon ose mund te vihen ne rrezik;

4.6 Nese Barredhenesi falimenton ose ndaj tij fillojne procedura falimentimi vullnetare apo te detyruara.

5. Mjetet ligjore

Ne rast mospermbushje, perveç te drejtave dhe mjeteve ligjore qe parashikohen nga ligji, Barremarresi mund:

5.1 vete ose perfaqesuesit e tij, por gjithmone me pelqimin e Barredhenesit, te verifikoje kontratat ne baze te cilat do te arketohen te ardhurat nga Kolaterali Specifik ose ndonje pjese e tij, me qellim qe te marre/kaloje te drejtat kete kolateral

5.2 te deklaroje, kur e gjykon te nevojshme, menjehere si te detyrueshme per Barredhenesin qe t'i paguaje te gjithe borxhin qe i detyrohet, duke perfshire borxhin e siguruar pa pasur nevoje per kerkese ose njoftim te çdo lloji, dhe te arketoje te gjithe borxhin qe i detyrohet me shpenzime te arsyeshme perfshire kostot e gjykates, pagimin e avokateve dhe shpenzime te tjera ligjore;

5.3 perveç te drejtave te parashikuara me siper dhe atyre qe garanton ligji, Barremarresi ka, si para ashtu edhe pas mospermbushjes, te gjitha te drejtat dhe mjetet ligjore qe i sigurohen nga Ligji "Per barret siguruese", duke perfshire te drejten per te ekzekutuar kolateralin specifik

6. Te ndryshme

6.1 Barredhenesi autorizon Barremarresin te rregjistroje formularet e njoftimit te rregjistrimit dhe dokumenta te tjere dhe te ndermarre te gjitha veprimet qe Barremarresi mund te mendoje se jane te nevojshme per te kompletuar dhe vazhduar kompletimin e Barres Siguruese, per te mbrojtur dhe ruajtur Kolateralin Specifik dhe per te ekzekutuar barren siguruese;

6.2 Kjo marreveshje eshte pjese e Kontrates se Kredise dhe e detyrueshme si per palet nenshkruese, ashtu dhe per personat qe mund te zene vendin e tyre ose te cileve u jane transferuar te drejtat apo detyrimet.

6.3 Palet mund te ndryshojne vetem me shkrim elementet e kesaj marreveshjeje dhe t'i pasqyrojne ato ne Regjistrin e Barreve Siguruese.

6.4 Mosmarreveshjet e paleve zgjidhen me mirekuptim, në të kundërt palët përcakojnë si kompetenca territoriale për zgjidhjen e ceshtjes Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane.

6.5 Marreveshja nenshkruhet ne 4 (kater) kopje me vlere te njejte.

KREDIDHËNËSE / BARRËMARRËSE
Për UNION BANK sh.a.

Përfaqësuar nga:

BARRËDHËNËSI
"ADRIATIC BAY INVESTMENT GROUP" Sh.P.K.
Përfaqësuar nga:
Z. AHMET KASTRATI

Unë noteri/ja pasi ju lexova përmbajtjen e kësaj kontrate palëve, konstatova se ajo vinte në përputhje me qëllimin e tyre dhe pasi ata e nënshkruan me vullnetin e tyre të plotë e të lirë në praninë time, vërtetoj nënshkrimin e tyre sipas ligjit.

NOTER/E

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

OKB Qendra Kombëtare e Biznesit National Business Center

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT " SHOQERI E THJESHTE"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L51621501S	
2. Data e Regjistrimit	21/04/2015	
3. Emri i Subjektit	Shoqeria konçesionare Porti MBM (Multi Buoy Mooring)	
4. Forma ligjore	E Thjeshte	
5. Data e themelimit	17/03/2015	
6. Kohëzgjatja	Nga: 17/03/201517/03/2050	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Durres Durres DURRES Porto Romano	
8. Vlera e kontributeve	100,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00	
9. Objekti i aktivitetit	Port detar' per shkarkimin e anijeve te hidrokarbureve. Germime dhe mirembajtje te basenit portual. Kordinimi i aktiviteteve tregtare brenda teritorit te portit. Ndertim, riparim ,restaurim,menaxhim ruajtje objektesh brenda portit. Shkarkim ,depozitirn e transport mallrash per llogari te subjekteve juridike dhe shteterore. Punime ndertimi si dhe ripanim te infrastruktures portuale. Sherbime te Ormexhimit. Administrim i Terminaleve. Administrim te Pontileve. Sherbimi i rimorkimit te tankerave. Furnizim me uje. Furnizim me ushqime dhe materiale teknike. Furnizim me karburant. Terheqje mbetjesh te ngurta dhe vajore nga anijet ankoruese. Sherbime agjensie detare ,doganore, spedicionere e ndermjetesimi.	
10. Administratori/ët	Ahmet Kastrati	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 19/12/2019	Deri: 19/12/2024
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	SALILLARI	
12.1 Vlera e kontributit	Para: 1,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve		
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	1,00	
13. Ortakët	ADRIATIC BAY INVESTMENT GROUP SHPK	
13.1 Vlera e kontributit	Para: 99,00	Natyre:
13.2 Numri i pjesëve		

Kopje nga web

13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	99,00
14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	
15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: Shoqeria konçesionare Porti MBM (Multi Buoy Mooring) E-Mail: info@portimbm.al Telefon: 0676032346
16. Statusi:	Aktiv

Datë: 30/06/2021

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Kopje nga web

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

QKB Qendra Kombëtare e Biznesit National Business Center

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT " SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L82320043A	
2. Data e Regjistrimit	20/11/2018	
3. Emri i Subjektit	ADRIATIC BAY INVESTMENT GROUP SHPK	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	17/11/2018	
6. Kohëzgjatja	Nga: 17/11/2018	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Sheshi Italia, Mark Albania Hotel, kati i pare, 1000 Tirane	
8. Kapitali	100,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00	
9. Objekti i aktivitetit	Investime dhe sherbime ne fushen e hidrokarbureve, sherbime portuale dhe doganore, si dhe sherbime te ndryshme detare. Pjesemarrje dhe iniciativa te tjera koncesionare. Administrimin e aktivitetit ne zona te lira doganore; Kryerjen e veprimtarise se agrobiznesit, si: grumbullim, perpunim dhe shitje te produkteve bujqesor; ose blegtorale. Kryerjen e veprimtarise se grumbullimit, magazinimit dhe shperndarjes se produkteve te ndryshme industriale.	
10. Administratori/ët	Ahmet Kastrati	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 17/11/2018	Deri: 17/11/2023
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	KASTRATI GROUP	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 65,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	65,00	
12.4 Komente (nëse ka)		
13. Ortakët	EUROPETROL GROUP	
13.1 Vlera e kapitalit	Para: 35,00	Natyre:
13.2 Numri i pjesëve		

Kopje nga web

13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	1,00
	35,00
13.4 Komente (nëse ka)	
14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Durres Durres DURRES Rruga Shën Pali, Porto Romano, Durres, (Depozitat e Hidrokarbureve).
15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: ADRIATIC BAY INVESTMENT GROUP SHPK E-Mail: ahmet.kastrati@kastrati-group.com Telefon: 0676032346
16. Statusi:	Aktiv

Datë: 30/06/2021

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Kopje nga web